

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË “BIOLAND” SH.P.K

Sot më datë 29.03.2024, me nismën e lirë të themeluesit:

OLSI BREGU, atësia Gramoz, i datëlindjes 10.12.1982 lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr BI4226522 dhe me nr. personal I21210106H, madhor dhe e zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e "ortakut themelues", deklaroj se:

Me vullnetin tim të lirë dhe mbështetur në Ligjin me Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe me Ligjin me Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeloj sot në datë 29.03.2024, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “BioLand” Sh.p.k me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

1.1 Themeluesi do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta quajë “BioLand” shpk, e cila do të funksionojë sipas dispozitave të aktit të themelimit dhe statutit të Shoqërisë.

Neni 2

- 2.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në Tiranë në adresën Rruga "Robert Zhvarc", Nr.2, H.4, Ap.29, Njësia Bashkiake nr. 5, Kodi Postar 1022, Kodi i banesës 1844048, Tiranë.
- 2.2 Me vendim të Ortakëve mund të hapen degë, filiale ose përfaqësi, brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 3

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj me një afat të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare e Biznesit (QKB), me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe në statutin e shoqërisë, ose me vendim të ortakëve.

Neni 4

- 4.1 Organet Drejtuese të Shoqërisë janë: Ortakët e shoqërisë dhe Administratori.
- 4.2 Administratori i shoqërisë do të jetë Z. Altin Yzeiri, i biri i Bilbil, me datëlindje 28.07.1975, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. ID 035418201 dhe nr. Personal H50728113H, për një periudhë pesë (5) vjecare, duke filluar nga data 29.03.2024 deri në datën 29.03.2029.

Neni 5

5.1 Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj :

→ *Veprimtari në fushën e prodhimeve blegtorale e bujqësore, krijimin e komplekseve blegtorale e bujqësore për prodhimin e produkteve dhe të nënprodukteve blegtorale e bujqësore, si dhe në*



marketing. Shoqëria do të prodhojë, të manipulojë, të përpunojë, të ruajë, të klasifikojë, të transportojë, të shpërndajë si dhe të tregtojë produkte blegtorale dhe bujqësore, në gjendjen e tyre natyrore ose të përpunuara. Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj edhe importimin dhe eksportimin e produkteve dhe nënprodukteve blegtorale e bujqësore.

- *Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është dhe veprimtaria në fushën e ndërtimit për objekte civile, industriale, komplekse bujqësore dhe blegtorale për vete apo për persona të tjerë fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, ndërtimin e linjave për prodhimin e produkteve e nënprodukteve blegtorale e bujqësore.*
- *Shoqëria, në funksion të objektit të saj të veprimtarisë, mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetërë cila është e lidhur dhe në ndihmë të objektit kryesor të veprimtarisë.*

Neni 6

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000** (njëqind mijë) **Leke**. Kapitali i mësipërm është tërësisht i shlyer dhe i nënshkruar nga 1 ortak, dhe përbehet nga 1 (nje) pjese me vlerë 100,000 (njëqind mijë) Lekë, që zotërohet nga ortaku Olsi Bregu, dhe që përbën 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

7.1 Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme, të drejta, krah pune dhe shërbime).

Neni 8

8.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akti themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj dhe në dispozitat e Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe të Ligjit me Nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 9

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjor.

THEMELUESI

OLSI BREGU

